

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Majko reagon për liderët e UÇK: Dënimet në Hagë e kanë kthyer politikën shqiptare në varrezë ambiciesh
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/majko-reagon-per-lideret-e-uck-denimet-ne-hage-e-kane-kthyer-politiken-shqiptare-ne-varreze-ambiciesh/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 15:47:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:43:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c45279853c7bcd39baba604df6c0f9b314f6c342a2b3e9c1e4d716f74f8f67a
TEKSTI	877c047253ad24f3a5e18f76120fee97f261ed6aee74a52f7cef4504a511391
PAMJA	3e656ccc8a11e376ddd0c1892c771d5048f3ee181628b39a0c1e12c087b67fe0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	274c5e4f1dd4e2a346a34852ca1f069fcaf817d26214979c981dddfb222dc985
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c772b20bb2a9907638c08fb1d7825d304059f9fa1ba842ea47b37301891e0c1b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/274c5e4f1dd4e2a346a34852ca1f069fcaf817d26214979c981dddfb222dc985>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Majko reagon për liderët e UÇK: Dënimet në Hagë e kanë kthyer politikën shqiptare në varrezë ambiciesh

LAJME E SHTUNË, 19 SHTATOR 2026 17:43



Pandeli Majko, ish-Kryeministri shqiptar i Luftës së Kosovës, ka reagu në Facebook pas vendimeve të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-drejtimesve të UÇK-së, duke ngritur pyetjen "Ku gabuam?".

Majko e cilëson situatën si një moment reflektimi për politikën shqiptare dhe shprehet se dënimet kanë prodhuar një krizë që, sipas tij, nuk është vetëm politike, por prek edhe mënyrën se si do të perceptohet trashëgimia e UÇK-së nga brezat e rinj.



Reagimi i plotë:



KU GABUAM... ?

Pas deklarimit të vendimeve të Hagës në dënimin për "krime lufte" të drejtuesve të UÇK-së, vjen një reflektim i cili bllokohet nga pyetja "Ku gabuam?"...

Dënimet e fundit në Hagë e kanë kthyer politikën shqiptare në një varrezë ambiciesh!

Prezenca e politikanëve sot, i ngjan shpejgimit dorëzues se "... në fund, nuk munda të bëj asgjë, veç të isha i pranishëm!"

Në të tilla momente njeriu sajton histori për ti dhënë kuptim të shkuarës... derisa trillimi zëvendëson të vërtetën! Ky është ngushëllim por jo justifikim!

Ngushëllimi i parë është ai që UÇK doli e pastër nga gjykimi në Hagë! UÇK po rikonsiderohet si një "ushtri e mirë" por me drejtues të akuzuar për krime lufte!...

Kriza që prodhoi Haga, nuk është vetëm politike! Ajo do të ngrejë pyetje të vështira nga shqiptarët e rinj për këtë trashëgimi e cila po legalizohet në Hagë!

Përgjigjet që nuk thuhet sot, do të kuptohen nesër!

LAJMET KRYESORE



"Tirana duhet t'i nderojë", Erion Veliu propozon që ish-liderët e UÇK-së të shpallen "Qytetarë Nderi"



Nga fjalimi në OKB tek takimet me diasporën, Rama me një axhendë të ngjeshur në Amerikë



Ambasada e Amerikës: Hap gjigant për Shqipërinë, nënshkrimi i marrëveshjeve Artemis në selinë e NASA-s



Burri vret bashkëshortin në sy të nipit 14-vjeçar, arratiset nga vëndngjarja. Reagon edhe Policia



4 ndeshje në Nations League, Maran grumbullon 29 lojtarë. Del lista zyrtare

TË PËRZGJEDHURA



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjerminë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modriç konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

MË TË LEXUARAT

"Krimet e luftës" për të cilat akuzohen drejtuesit e UÇK-së janë kryesisht të periudhës së PAS LUFTËS, mbas nënshkrimit të marrëveshjes së Kumanovës, ku Jugosllavia e mbetur, firmosi humbjen e Luftës!

"Krimet e luftës" janë pjesë e betejave politike se kush do të drejtonte Kosovën PAS LUFTËS!

Tek "krimet e luftës" u paketuan dëshmitë e spiunëve të Serbisë me ata që u përplasën politikisht me ish drejtuesit e UÇK-së kryesisht, PAS LUFTËS!

Tek "krimet e luftës" u ndërlihdën akuzat për korrupsion për ish drejtues të UÇK-së PAS LUFTËS!

Për ata që vlerësojnë se me gjykimin e Hagës për shpalljen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit si "kriminel lufte" është vendosur drejtësia kanë një gabim në interpretim!

Serbia si aktorja më aktive e gjykatës së Hagës për dënimin e shqiptarëve nuk i intereson se çfarë ka ndodhur PAS LUFTËS! Ajo kërkon një justifikim substancial për domethënien e krimeve të saj shtetërore karshi shqiptarëve!

Serbët janë një komb i edukuar me narcizisëm! Serbia dëshiron të fitojë LUFTËN e humbur në librat e historisë!

Vendimi për "krime lufte" për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin janë të mjaftueshme për "revanshin" në betejën e historisë së shkruajtur!

Vini re që dënimet maksimale janë për Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin të cilat kanë qenë fytyrat më publike të UÇK-së gjatë Luftës!

Krenaria në historinë e shqiptarëve pas Skënderbeut nuk ka fytyra udhëheqësish! Të gjithë kanë nga një "bisht" me akuza për tradhëti apo diktatorë!

Kjo është pjesë e dramës shqiptare dhe deformimit që kundërshtarët e tyre gjeopolitik kanë nxitur! Por ajo është pasojë edhe pasionit pa kufizime dhe egos së drejtuesve të një kombi me histori shtetërore modeste!

Deformimet për ti trajtuar shqiptarët si komb i dështuar hyn tek një teknikë historike që nuk shkruhet por nënkuptohet!

Luftërat serbe fillojnë në libra për të vazhduar në realitet! Vendimi i Hagës ishte i rëndësishëm për "librin" e ri të RIKTHIMIT të Serbisë në Kosovë...

Ndaj sot, reflektimi se KU GABUAM duhet të jetë kolektiv!

Pyetja më e rëndë, është PSE në Hagë humbëm betejën me Serbinë? Përgjigja se na "tradhëtuan"... është veç ngushëllim!

ETIKETA PANDELI MAJKO

MË SHUMË NGA LAJME



Rama në OKB: Anëtarësimi në BE deri në 2030, pjesë e transformimit të...

IKMT vijon aksionin në Shkodër, lirohen hapësirat pranë shkollës "Mat..."

Ministri Nufi: 26 efektivë të FA trajnim me fokus terminologjinë tekn...



Berisha paralajmëron ndryshime në PD: Ripërtëritje dhe dixhitalizim, ...



Nga fjalimi në OKB tek takimet me diasporën, Rama me një axhendë të n...



Nga konventa republikane te takimet me zyrtarët amerikanë, Berisha: T...

LAJMET E FUNDIT





Majko reagon për liderët e UÇK: Dënimet në Hagë e kanë kthyer politikën shqiptare në varrezë ambiciesh

[31 SEKONDA MË PARË](#)



Putin akuzon NATO-n: Disa liderë evropianë po përgatiten për luftë me Rusinë

[26 MINUTA MË PARË](#)

Rama në OKB: Anëtarësimi në BE deri në 2030, pjesë e transformimit të Shqipërisë!

[47 MINUTA MË PARË](#)



E qëllloi me thikë, flet 68-vjeçari që vrau gruan: I thosha të rrinte tek shtëpia jonë ...

[1 ORË E 5 MINUTA MË PARË](#)



Pas Hagës dhe Prishtinës, protesta të reja të diasporës shqiptare në Evropë dhe Kanada

[1 ORË E 31 MINUTA MË PARË](#)



Gjermania ul taksat për karburantet, paketa 2.5 miliardë euro

[1 ORË E 49 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONE" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.